



Republika e Kosovës

Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)-

01.Nr. zyrtar/ 2018

Procesverbal

Takimi i V-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2018

Më 22.10.2018

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetarë i Komunës

Jaser Jaha, zv.Komandant i Policisë-Kaçanik

Kjani Sallahu, (mediet, OJQ-të, zejtarët, PAK-të)

Fatmir Qaka,EVSB

Ramadush Osmani-Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

Zahir Doda-Drejtor i DAK

Menduh Rexha-Bashkësia Islame

Shemsedin Abazi-(KLSP)

Munguan:**Fadil Guri** , **Vedat Dema** , **Ali Vishi** , **Jashar Selimi** dhe **Lirije Luta**

Monitorues: zyrtarë nga OSBE dhe Ministria Pushtetit Lokal

Në takim prezent me ftesë të Kryetarit të Komunës ishin edhe **Shabi Idrizi** përfajqsues nga Gjykata dhe **Vlora Runjeva** nga kompania „**Pastërtia**”

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Kaçanikut **z. Besim Ilazi** dhe propozoi këtë rend dite:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut
- 3.Formimi i grupit punues për hartimin e Planit të punës për vitin 2019
- 4.Të ndryshme

1. Miratimi i procesverbalit nga takimi i kaluar

-Procesverbali u miratua nga të pranishmit

2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut

-Reth kësaj pike raportoi zv.**Komandanti i Policisë** i i cili tha se gjendja e sigurisë në Komunën tonë për momentin është e qetë dhe nuk ka indikacione për përkeqësim të situatës. Siguria nëpër shkolla është ndër priorititetet që kemi renditur në planin operativ .Për të rritur sigurinë e qytetarëve ne kemi hartuar edhe një plan të përgjithshëm operativ .

Në objektin e BK-Center në një kafiteri ka ndodhë një përlleshje në mes dy grupeve të të rinjëve me qrast janë shkaktuar edhe lëndime trupore të disa personave .Disa nga këta persona janë intervistuar dhe hetimet për kët rast janë duke vazhduar.Në kët lokal shpesh po ndodhin probleme për qka ne do të bëjmë një raport më të detajuar me qëllim që ndaj pronarit të lokalit të mirren masa.

-**Shabi Idrizi**-është duke u shtuar numri i veprave penale,dukuritë e vjedhjeve,përdorimi i narkotikëve etj dhe kërkoj të ndërmirren masa parandaluese sidomos ndaj të rinjëve të cilët ekspozohen në këto dukuri

-**Kryetari**:këto janë shqetsime të përbashkëta dhe së bashku duhet të punojmë në preventivë me qëllim që këto dukuri mos të përhapen.Kompania Bechtelenka nuk është treguar serioze në bashkpunim në ndriqimin e rasteve të vjedhjeve që kanë ndodhur gjat punimeve që janë bërë në autostradë.

-**Kjani Sallahu-Dukuria** e vjedhjeve është duke u rritë me të madhe dhe kjo është si derivat i veprimeve të kundërligjshme në teren.Edhe një herë kisha apelu tek organet kompetente , në këtë rast tek gjykata, që lëndët e veprave penale të shqyrtohen e të mos mbeten në sirtarë kohë të gjatë, ku pastaj këto lëndë vjetrohen dhe kryerësit e veprave kalojnë pa u ndëshkuar.

Ndër ngjarjet që e kanë karakterizuar periudhën dymujore ndërmjet dy takimeve të fundit të KKSBB-së, janë:

- Këtu nuk u reportua, por ka informacione të konfirmuara jozyrtarisht se, më 9 shtatororganet e sigurisë janë penguar në punën e tyre dhe kjo paraqet shqetësim

serioz për qytetarët, fakti që edhe policia nuk është e sigurtë. Edhe për këto raste duhet të raportohet edhe në KKSB.

- Aksi rrugorë Kaçanik-Hani i Elezit është bërë një rrezik i madh për vozitësit e automjeteve. Tashmë ka ndodhur edhe një aksident ku një veturë ka rënë nga rruga poshtë, në vendin aksidentit fatal të policëve të ndjerë. Është mirë që Komuna jonë dhe ajo e Hanit të Elezit të interesohen në Ministrinë e Infrastrukturës që përgjatë këtij aksi të vendosen muret mbrojtëse, ngase me lëshimin e autostradës do të bie edhe interesimi për përkujdesje në këtë aks rrugorë nga niveli qendror, e pasojat do ti kemi ne dy komunat që potencialisht e frekuentojmë këtë aks rrugor.
- Gjendja jo e mirë e rrugës magjistrale është edhe afër vendit "Uji i Nxehtë", ku është bërë një gropë qërrezikon përbysjen e automjeteve. Duhet bërë kërkesë Ministrisësë Infrastrukturës që, të bëjnë riparimin e pjesëve të dëmtuara të këtij aksi rrugorë, para se të ndodhë ndonjë aksident.
- Prerja e pyjeve po vazhdon dhe brengosë fakti se, sipas informacioneve të shumta, kjo dukuri po sponsorohet dhe inkurajohet nga zyrtarët kompetentë qëjanë të thirrur për mbrojtjen e pyjeve. Përderisa ndodh kështu, nuk kemi të drejtë t'i ndëshkojmë prerësit e pyjeve.
- Trotuari pran Xhamisë së qytetit mirë qëështë bërë, por fakti që aty parkohen vazhdimesh automjetet, përveç se ky projekt nuk është duke u shfrytëzuar konform qëllimit për të cilin është realizuar, mendoj se kemi bërë edhe mëkat që i kemi lëvizur eshtrat nga dy varret në atë pjesë. Ky trotuar duhet të shfrytëzohet vetëm për këmbësorë dhe për asgjë tjeter.
- Si pasojë e punimeve në autostradë në masë të madhe është dëmtuar edhe rruga prej Fushës së Pajtimit deri në fshatin Semajë. Duhet të riparohet tërëisht ai dëm.
- Më intereson të di për shkaqet dhe pasojat e zjarrit të përhapur javën e kaluar, në një banesë afër postës.
- Dhe krejt në fund, propozoj që në qendër të qytetit, tek ura e lumit Nerodime, të mendohet për rregullimin e një rrith rrrotullimi për një qarkullim më të lehtë të automjeteve.

-Shabi Idrizi-sa i përket prerjes së pyjeve ne kemi shumë lëndë që po përpinqemi ti shqyrtojmë, po më habitë fakti se nuk kemi kërkesa për konfiskim të automjeteve që

transportojnë dru.Këto automjete dërgohen në parkingun e Invalidëve të Luftës , shkarkohen,mbahen automjetet 24 orë dhe liron.

-**Kryetari-më** brengosë fakti se ka shumë automjete nëpër pyje që ngarkohen me masë drusore e që janë pa tabela e nuk mirren masa.

-**Jaser Jaha-ne** si stacion i policisë me një vendim të Komunës mjetet që transportojnë ilegalisht masën drusore i kemi dërgu në parkingun e Invalidëve të Luftës dhe konfiskimi është bërë në bashkpunim me rojet e pyjeve.Më vonë Prokuroria nuk na kan leju që të punojmë në bazë të këtij vendimi.Për automjetet pa tabela dhe pa regjistrim ne i ndalojmë dhe lëndën e përcjellim në njësitin për auto krime që mirren me kët punë dhe kërkesa jonë ka qenë që automjetet të barten me kompaninë e kontraktuar.

Sa i përket zjarrit në një ndërtesë si shkak ka ardhur nga një bombolë gazi dhe pasoja të rënda nuk ka.

Në trotuarin pran xhamisë së qytetit një person me aftësi të kufizuara që gjindet jashtë vendit ka marrë leje nga Komuna që të ju sigurohet një vend parking dhe e shfrytzon gjat kohës kur është në pushime ndërsa në raste tjera ne vodosim xhoba.

-**Shemsedin Abazi**-Te stadioni i qytetit ka ndodhë thyerja e objektit me qka është demoluar ky objekt dhe më intereson të dijë se ku keni arritur në zbulimin e këtij rasti.

-**Jaser Jaha**-Jemi marrë me kët rast dhe hetimet po vazhdojnë

-**Zahir Doda**-u jam mirënjoës Policisë së Kosovës për punën që po bëjnë sidomos në sigurinë e nxënësve nëpër shkolla por që brengosësë është jo interesimi i prindërve përfëmijët e tyre.

-**Kryetari-rruga e maxhistralës** edhe pas lëshimit të autostradës do të mbetet nën kompetencat e Ministrisë së Infrastrukturës.Ne si komunë shpesh i kemi ngritë shqetsimet tonë për dëmtimet e këtij aksi rrugorë dhe problemet tjera që paraqiten në kët aks.Dukuria e prerjes së pyjeve është një shqetsim për ne por që shoh një neglizhencë të Ahxensionit të Pyjeve që nuk po e kryejnë punën e tyre si duhet.Është mirë të krijohet një hallkë zingjirore e bashkpunimit të institucioneve relevante që të pengojmë kët dukuri.Për rrugët e dëmtuara nga punimet e autostradës ne kemi një premtim gojorë nga Ministria e Infrastrukturës që pasi të përfundojnë punimet do të bëhet edhe riparimi i rrugëve të dëmtuara.

Qështja e rrethrrrotullimit te ura e lumbit Nerodime në qendër të qytetit edhe pse është hapsirë jo e mjaftueshme kërkoi nga të gjithë që të japid ide se si do të duket ky rrethrrrotullim.

-Menduh Rexha-Në dalje të xhamisë edhe pse egziston shenja që ndalon parkimin e veturave, persona të pandërgjegjshëm nuk po e respektojnë kët shenjë dhe po pengojnë kryerjen e shërbimeve që bëhen në kët pjesë të xhamisë.

Ramadush Osmani-Dua të di nga ana e policisë në lidhje me kamerat e sigurisë se a janë funksionale dhe sa janë rastet e zbuluara me vendosjen e këtyre kamerave. Kohëve të fundit është bërë një investim në ulëse rrëth lumi Nerodime dhe është mirë që të kujdesemi rrëth këtij investimi

-Jaser Jaha-kamerat e sigurisë janë funksionale dhe kemi shum raste ku falë funksionimit të këtyre kamerave kemi arritë të jemi më efikas në kryerjen e detyrës tonë. Është mirë që në të ardhmën të mendojmë në mirëmbajtjen e këtyre kamerave.

-Ramadush Osmani-Ne si drejtori do të planifikojmë që nga viti i ardhshëm të fusim si prioritet edhe mirëmbajtjen e ndriqimit publik por edhe të kamerave të sigurisë.

-Kjani Sallahu-Kamerat e sigurisë janë vendosur që të punohet edhe në parandalimin e veprimeve kundërligjore, prandaj më intereson të di sa po përdoren ato për këtë qëllim. Mendoj që me ato kamera duhet të vëzhgohen hapësirat e monitoruara vazhdimesh dhe për shkeljet eventuale të rendit, të intervenohet menjëher. Qytetarët duhet ta dinë që rregullisht janë nën vëzhgim dhe kjo së paku parandon kundërvajtjet e përditshme në trafikun e qytetit. Përditë shohim raste që automjetet parkohen në vende të ndaluara dhe bëhen veprime të ndaluara edhe në ato pjesë ku ka kamera. Mungesa e veprimeve të policisë, qytetarëve u lë përshtypja se këto kamera janë jo-funksionale.

-Jaser Jaha-Ne kemi një zyrtarë që vëzhgon punën e kamerave të sigurisë por qështë e pamundur që të përcillen të gjitha hapsirat në të njetën kohë.

-Kjani Sallahu-Shqetësim i madh është edhe shkarkimi i ujrave të zeza në lumin Nerodime nga komuna e Ferizajit ku, si pasojë këtyre ditëve kemi parë edhe peshqë të ngordhur në lum.

-Kryetari-pos lumi Nerodime shkarkime të ujrave të zeza kemi edhe në lumin Lepenc dhe ne si komunë kemi bërë raporte për Ministrinë. Është në plan ndërtimi i një impianti në dalje të Ferizajit por qështë i kushtueshëm dhe do të zgjasë shumë kohë.

3. Formimi i grupit punues për hartimin e Planit të punës

për vitin 2019

-Kryetari përgëzoi grupin punues që ka punuar në planin e punës për kët vit dhe propozoi që i njeti grup të punojë edhe në përgatitjen e Planit të Punës për vitin 2019.

Me kët propozim u pajtuan të gjithë dhe në kët plan do të punojnë Zahir Doda, Lirije Luta dhe Kjani Sallahu në konsultim me anëtarët tjerë të KKSBB-së

4.Të ndryshme

-Rreth pikës së fundit të rendit të ditës, fjalën mori **Kjani Sallahu** i cili shprehu shqetësimin e tij rrëth kulturës së debatit në seancën e fundit të Kuvendit Komunal. Deklaratat me motive nxitëse lokaliste e të përzgjedhurëve të popullit, të cilat kanë vetëm qëllime politike dhe asgjë tjetër, nuk duhet përdoren me tendencë. Këshilltarët nuk duhet të nxisin revolta, përkundrazi Kuvendi duhet të shfrytëzohet për zbutjen dhe eliminimin e revoltave eventuale me motive të ulta. Asnjëher nuk kam menduar që edhe në KK mund të prodhohen situata destabilizuese. Duhet të bëjmë shumë kujdes.

-**Kryetari-Ë** shtë e vërtetë se ndonjëherë nuk respektohet rregullorja e Kuvendit por që në temën rrëth investimeve me prezentimin e argumenteve nga ana ime në një far forme u pajtuan të gjithë.

-Në kët pikë të rendit të ditës u inkuadrua edhe **Vlora Runjeva** përfajqsuese e Kompanisë „Pastërtia” e cila tha se përkundër vështirive që ka kjo kompani me mungesë të mjeteve makinerike dhe të amortizuara të punës , ne po mundohemi që të kryejmë detyrat tona , duke ofruar shërbim në mbledhjen e mbeturinave . Problemet do të shtohen në sezonin e dimrit që do të kemi vështirsi në kryerjen e shërbimeve por që shpresojmë që në një projekt me organizatën GIZ ,do të zbusim kët situatë.

-**Zahir Doda**-sa i përket problemit të mbeturinave ne duhet të jemi edhe vet kritik ngase shërbimet komunale duhet paguar dhe apeloj që të ngritet vëtdija qytetare në kët aspekt.

-**Kjani Sallahu**- Menaxhimi i mbeturinave nuk ështënë nivel. Është e vërtetë se kapacitetet që i nevojiten kësaj kompanie janë të pamjaftueshme dhe të vjetërsuara, por kjo situatë ose do zgjidhje ose imponon intensifikimin e ndryshimit të ligjit, në mënyrë që të themelohet një ndërmarrje komunale për mbeturina ose qëky shërbim t'i besohet sektorit privat. Nëse pagesa është, siç thuhet, 70 për qind, shërbimet duhet të kryhen 100 për qind. Kompania ka 27 punëtorë dhe ka vetëm një kamion, një minikamion dhe një traktor. Ska logjikë funksionimi i saj. Një menaxhment i mirë do të interesohej për kapacitete të plota teknike e logistike, e jo vetëm përritjen e numrit të të punësuarve. Për mungesë të mekanizmit teknik i lihet vazhdimesht faji kompanisë në Ferizaj, por për punësim ska pengesa nga askush. Është shumë e nevojshme që udhëheqësin e njësisë ta kemi në takim, pa dashur ta injorojmë prezencën e përfaqësueses këtu.

-**Vlora Runjeva**-pos defekteve në makineri si kompani po ballafaqohemi edhe përvendeponi të cilat nganjëherë edhe po mbyllen. Problemi tjetër është se është shtuar edhe

numri i klientëve të rinjë dhe ne përshkak të këtyre kapaciteteve të mangëta që kemi ,është vështirë të kryejmë shërbimin si duhet.

-**Fatmir Qaka**-është mirë që për qdo ndryshim orari të mbledhjes së mbeturinave nëpër lokacione të njoftohen qytetarët me kohë përmes njoftimeve nëpër lagje,web.faqën e Komunës dhe në rrjetet sociale me qëllim që mbeturinat mos të mbesin kohë të gjatë nëpër rrugë.

REKOMANDIMET:

- 1.Të mirren masa ndaj kafiterisë në objektin e BK-CENTER për problemet e shpeshta që po ndodhin në këtë lokal
- 2.Të punohet në preventivë për pengimin e dukurive negative tek të rinjët
- 3.Të shqyrtohen lëndët e veprave penale e të mos mbesin në sirtarët e Gjykatës kohë të gjatë
- 4.Të kërkohet nga Ministria e Infrastrukturës që të bëjnë riparimin e rrugës magjistrale dhe atyre lokale nga pasojat e punimeve në autostradë.
- 5.Të mendohet për rregullimin e një reth rrrotullimi në qendër të qytetit
- 6.Të krijohet hallkë zingjirore e bashkpunimit të institucioneve relevante në pengimin e dukurisë së prerjes së pyjeve.
7. Të mirren masa ndaj parkimeve ilegale
- 8.Kujdesë i shtuar rreth investimeve në hapsirat publike
- 9.Të ngritet vtdija qytetare për kryerjen e obligimeve ndaj shërbimeve komunale
- 10.Të investohet në ngritjen e kapaciteteve në kompaninë „Pastërtia”

Pas këtyre rekomandimeve, Kryetari përmbylli takimin për t'u takuar në mbledhjen e radhës

Kaçanik 22.10.2018

Kryesuesi:

Kryetari i Komunës

z.Besim Ilazi



Procesmbajtës:

Fatmir Çaka